

**AKT THEMELIMI DHE STATUT**  
**I**  
**SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**

**The Agent SHPK**

**Sot me daten 10/10/2023 (dymije e njezet e tre) ne Tirane, Shqiperi, jane prezent:**

Znj. Marlinda Zotaj, vajza e Volmandit dhe Fatmires, shtetase shqiptare, lindur ne Tirane, me 11/05/1981, me numer Karte Identiteti 036724810 dhe numer personal I15511076C, banues ne Rruga Tish Daija, Kompleksi Kika 2, p 7, H 1, Ap 33, Tirane.

e cili vepron ne cilesine e themeluesit te vetem ligjor te Shoqerise me pergjegjesi te kufizuar,  
me zotesi te plote per te vepruar dhe kuptuar,  
E cili kerkon themelimin e nje Shoqerie me pergjegjesi te kufizuar, ne perputhje me ligjin shqiptar dhe miraton sot dispozitat e ketij statuti dhe Akti Themelimi te Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar.

**Neni 1**

**Themelimi i Shoqerise**

Sot ne daten 10/10/2023, Une Themeluesi, themeloj nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, te quajtur **The Agent SHPK** (qe ketej e me tutje te quajtur "Shoqeria").


**Neni 2**

**Emertimi i Shoqerise**

1.1 Shoqeria e emertuar **The Agent SHPK**, eshte nje Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar e themeluar dhe qe ekziston ne perputhje me legjisacionin e Republikes se Shqiperise.

1.2 Shoqeria eshte themeluar sipas ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 " Per tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" i ndryshuar dhe fiton personalitet juridik pas rregjistrimit te saj ne Rregjistrin Tregtar Shqiptar te mbajtur prane Qendres Kombetare te Bisnesit (QKB).

1.3 Shoqeria e zhvillon aktivitetin e saj ne perputhje me legjisacionin shqiptar dhe kete Statut.



### **Neni 3**

#### **Selia**

- 2.1 Selia e Shoqerise ndodhet ne adresen : Rruga Abdyl Frasherri, pallati Teknoprojekt 2, kati 6, nr 21, Tirane Shqiperi.
- 2.2 Shoqeria mund te hape zyra perfaqesimi, dege dhe/ose filiale dhe/ose te marre pjesë ne Shoqeri te tjera, te kryeje aktivitet ne vende te tjera, brenda ose jashte territorit te Republikes se Shqiperise, ne perputhje me vendimet e Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, qe mund te miratohen here pas here.

### **Neni 4**

#### **Kohezgjatja**

Shoqeria do te ushtroje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te pacaktuar, duke filluar nga data e rregjistrimit te Shoqerise ne Rregjistrin Tregtar te mbajtur prane QKB.

### **Neni 5**

#### **Objekti**

Objekti i aktivitetit te Shoqerise do te jete: Agjent Imobiliar dhe konsulence ne fushen imobiliare, si dhe cdo lloj tjeter aktiviteti te lejuar dhe ne perputhje me ligjin shqiptar.

### **Neni 6**

#### **Kapitali**

6.1 Kapitali i nenshkruar dhe teresisht i shlyer eshte 1,000 Leke.

6.2 Kapitali fillestar do te jete i ndare ne 1 kuote, me vlore te barabarte nominale prej 1000 leke per kuote. Kapitali i nenshkruar dhe i shlyer teresisht eshte i ndare ne perputhje me kontributin e themeluesve si me poshte vijon:

1. Themeluesi Znj. Marlinda Zotaj, vajza e Volmandit dhe Fatmires, shtetase shqiptare, lindur ne Tirane, me 11/05/1981, me numer Karte Identiteti 036724810 dhe numer personal I15511076C, banues ne Rruga Tish Daija, Kompleksi Kika 2, p 7, H 1, Ap 33, Tirane.

*zoteruese e 1 kuote, te cilat perfaqesojne 100% te kapitalit te Shoqerise.*

Pergjegjesia e Ortakut shtrihet deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin e Shoqerise.

6.3 Rritja apo zvogelimi i kapitalit fillestar behet vetem me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve dhe vetem ne perputhje me ligjet ne fuqi.

## Neni 7

### Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve

7.1 Administratori(et), sipas gjykimit te tyre te lire ose me kerkesen Ortakeve, dhe/ose eksperti kontabel i miratuar, dhe/ose likujduesit (nese ka) mund te therrasin mbledhjen e Asamblese se Ortakeve, por te pakten nje here ne vit. Ortakeve ju dergohet nje njofitim me shkrim per mbledhjen me ane te postes se rregjistruar apo postes elektronike, jo me pak se 7 dite perpare dates se mbledhjes, qe permban te dhenat per arsyen e mbledhjes, vendin, daten dhe oren e saj.

7.2 Verifikimi i njoftimit te mbledhjes nuk eshte i nevojshem nese te gjithe Ortaket jane te pranishem apo te perfaqesuar ne perputhje me kete nen.

7.3 Nese nuk parashikohet ndryshe nga ligji apo nga ky Statut, cdo veprim i cili ndermerret nga Asambleja e Ortakeve mund te merret pa mbledhje, pa njofitim ose pa votim, nese per kete veprim do te behet nje konsultim me shkrim i cili duhet te percaktoje veprimet e ndermarra dhe do te nenshkruehet nga te gjithe Ortaket e Shoqerise.

7.4 Ne perputhje me legjislacionin shqiptar, Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve e thirrur rregullisht, perfaqeson te gjithe Ortaket e Shoqerise dhe eshte organi me i larte vendimarres i Shoqerise. Ne perputhje me legjislacionin shqiptar, Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve mund te marre vendimet e meposhtme, por pa u kufizuar vetem ne to:

- (a) Percaktimin e politikave te biznesit;
- (b) Emerimin dhe shkarkimin e Administratori(et)(eve);
- (c) Emerimin dhe shkarkimin e eksperteve kontabel dhe likujduesve;
- (d) Rritjen dhe zvogelimin e kapitalit te Shoqerise;
- (e) Miratimin dhe zbatimin e pasqyrave financiare per llogarite vjetore, te administrimit dhe te raporteve te mbikqyrjes;
- (f) Miratimin e rregullave proceduriale ne lidhje me mbledhjen e Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve;
- (g) Miratimin dhe shperndarjen e fitimit vjetor;
- (h) Miratimin e skemes se kompesimit per Administratori(et)n(et), likujduesin (it) dhe ekspertet kontabel;
- (i) Ristrukturimin, prishjen, transformimin, bashkimin, likujdimin e Shoqerise ose riorganizimin e Shoqerise ne ndonje forme tjeter;
- (j) Marrja e te gjitha masave me qellim qe Shoqeria te kete kapital dhe asete te mjaftueshme per ushtrimin e aktivitetit dhe permbushjen e detyrimeve kundrejt te treteve;
- (k) Te hipotekoje, lere peng dhe vendose barre mbi asetet e veta dhe te lidhe cdo marreveshje financiare me cdo pale financuese, me kusht qe hipoteka, pengu apo



barra tjeter, po ashtu si dhe marreveshjet perkatese financiare, te sherbejne per permbushjen e detyrimeve;

- (l) Krijimin, mbylljen dhe/ose prishjen e degeve, zyrave te perfaqesimit dhe filialeve;
- (m) Investime me vlore mbi 10,000 Euro;
- (n) Transferimin e aseteve te Shoqerise;
- (o) Cdo ceshtje tjeter qe percaktohet nga ligji i zbatueshem apo nga ky Statut.

## Neni 8

### Administrimi i Shoqerise

8.1 Shoqeria do te administrohet nga 1 Administrator,

Znj. Marlinda Zotaj, vajza e Volmandit dhe Fatmires, shtetase shqiptare, lindur ne Tirane, me 11/05/1981, me numer Karte Identiteti 036724810 dhe numer personal I15511076C, banues ne Rruga Tish Daija, Kompleksi Kika 2, p 7, H 1, Ap 33, Tirane.

8.2 Administratori, emerohet per nje periudhe kohore 5 vjecare me te drejte rizgjedhje. Administratori mund te shkarkohet perpara perfundimit te mandatit me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve.

8.3 Administratori(et) do te jete pergjegjes per administrimin frytdhenes, te dobishem e te kujdeshem te Shoqerise dhe do te perfaqesoje Shoqerine kundrejt paleve te treta ne lidhje dhe ne perputhje me dispozitat e ketij Statuti dhe/ose te ligjit/eve te zbatueshem. Administratori(et) ka kompetencia te plota per administrimin e zakonshem ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe per administrimin e jashtezakonshem te Shoqerise, te cilat do te percaktohen me vendim te Ortakeve, pervec atyre kompetencave te cilat ushtrohen nga organe te tjera te Shoqerise sipas ketij Statuti ose ligjeve te zbatueshme.

8.4 Administratori(et) do te kete kompetencat dhe detyrat qe lidhen me administrimin dhe mbikqyrjen e aktivitetit te Shoqerise, si me poshte vijon:

- (a) te mbikqyre dhe zbatoje politikat dhe veprimtarite tregtare te Shoqerise dhe vendimet e Asamblese se Ortakeve;
- (b) me kerkese se Asamblese se Ortakeve, te ndermarrë masa te cilat jane kompetence e kesaj te fundit, te propozoje vendimet qe do te miratohen nga Asambleja e Ortakeve dhe ti zbatoje keto vendime;
- (c) te siguroje qe Shoqeria respekton ligjin(et) e zbatueshem dhe standartet kontabel;
- (d) te kryeje te gjitha veprimet ne lidhje me administrimin e aktivitetit tregtar te Shoqerise;
- (e) te perfaqesoje Shoqerine kundrejt paleve te treta;
- (f) te siguroje qe dokumentat dhe librat kontabel te Shoqerise te mbahen ne rregull dhe me saktesi;



- (g) te therrasi mbledhjet e Asamblese se Pergjithshme kur e vlereson te nevojshem per mbrojtjen e interesave te Shoqerise;
- (h) te pergatise dhe nenshruaje pasqyrat financiare te Shoqerise, pasqyrat financiare te konsoliduara, te cilat bashke me propozimin e shperndarjes se fitimit i paraqiten per miratim Asamblese se Ortakeve;
- (i) te kryeje te gjitha rregjistrimet dhe publikimet e detyrueshem ne lidhje me Shoquerine, sipas parashikimeve te ligji te zbatueshem;
- (j) ti raportoje Asamblese se Ortakeve mbi zbatimin e politikave tregtare dhe aktivitetet e Shoqerise;
- (k) te miratoje hapjen e cdo procedure ligjore ose mbylljen e tyre.

8.5 Administratori(et) mund te ushtroje te gjitha kompetencat e Shoqerise si dhe te kryeje te gjitha veprimet qe me ligj ose per arsyte te tjera nuk jane kompetence e Asamblese se Pergjithshme, ose nuk kufizohen nga ky Statut.

8.6 Administratori(et) eshte perqejjes kundrejt Shoqerise dhe/ose paleve te treta per demet e shkaktuara nga shkelja e dispozitave te ketij Statuti ose te ligjeve te zbatueshem.

### **Neni 9**

#### **Njoftimet**

Sa here kerkohet dhenia e nje njoftimi kundrejt cdonjerit prej perfaquesuesve te Ortakeve dhe Administratori(et) ose anasjelltas, ky njoftim mund ti jepet personalisht ose duke derguar nje kopje me poste te rregjistruar, faks ose e-mail, ne adresen e tij qe rezulton ne librat e Shoqerise, ose qe ai vete i ka dhene Shoqerise per qellime njoftimi. Nese njoftimi dergohet me poste te rregjistruar apo faks, do te konsiderohet se i eshte dhene personit perkates 5(pese) dite pasi njoftimi eshte depozituar ne zyrat postare ose nga transmetimi i faksit apo sherbimi tek adresa e personit. Ky njoftim do te percatoje subjektin e njoftimit, sipas rastit.

### **Neni 10**

#### **Ekperti(et) Kontabel te Autorizuar**

Ekperti(et) Kontabel te Autorizuar do te emerohen me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, ne rastet kur parashikohet ne legjislacionin shqiptar. Riemerimi i Ekpertit(ve) Kontabel te Autorizuar do te behet ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi. Ekperti(et) Kontabel te Autorizuar mund te shkarkohen me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve ne rast shkeljeje te detyrave, gabimeve dhe sjellje jo te mire profesionale.

### **Neni 11**

#### **Viti Ushtrimor**

Viti ushtrimor fillon me 1 janar dhe mbaron me 31 dhjetor te cdo viti kalendarik, Perjashtimisht viti i pare ushtrimor fillon ne daten e rregjistrimit te Shoqerise ne Rregjistrin Tregtar Shqiptar dhe perfundon ne 31 dhjetor 2023.

### Neni 12

#### Shperndarja dhe Prishja

- 12.1 Shoqeria mund te shperndahet me vendim te Asamblese se Pergjithshme. Shperndarja e Shoqerise do te ndiqet nga prishja e saj.
- 12.2 Shoqeria do te ruaje personalitetin juridik, vetem per qellime qe lidhen me likujdimin dhe emertimi i Shoqerise gjate fazes se likujdimit do te ndiqet nga fjalet “ne process likujdimi”.
- 12.3 Likujdatori(et) do te emerohen me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve. Prishja e Shoqerise dhe emerimi i Likujdatori(ve) do te kryhet ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

### Neni 13

#### Ligji i Zbatueshem

- 13.1 Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plete me kete Statut dhe me dispozitat e ligjeve shqiptare te zbatueshme.
- 13.2 Ligji shqiptar per Shoqerite tregtare do te aplikohet per te gjitha aspektet te cilat nuk jane te rregulluara nga ky Statut.

Per cdo rast, aspekt apo ngjarje qe nuk parashikohet nga ky Statut, do te aplikohen dispozitat e ligjit shqiptar nr. 9901, date 14.04.2008, “ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare” i ndryshuar.

### Neni 14

#### Mosmarreveshjet

Cdo mosmarreveshje qe mund te linde ne lidhje me zbatimin ose interpretimin e ketij Statuti, si dhe cdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe paleve te treta, do te zgjidhet nga gjykata shqiptare kompetente.

### Neni 15



## Ndryshimet

Ky Statut mund te ndryshohet, rishikohet dhe/ose shfuqizohet pjeserisht ose teresisht dhe te zevendesohet me një Statut te ri me Vendim te Asamblese se Ortakeve.

### Neni 16 Te Ndryshme

Autorizoj Sabina Shytaj, shtetase shqiptare, e bija e Razipit dhe Alemes, me numer ID 033229865 dhe numer personal G85128087D, te ekzekutoje, dorezoje dhe nenshkrue elektronikisht, ne emrin tim, te te gjitha dokumentave te nevojshme per te plotesuar<sup>r</sup> dhe bere efektive, rregjistrimin e Shoqerise me pergjegjesi te kufizuar **The Agent Shpk**, prane Qendres Kombetare te Biznesit dhe cdo institucioni tjeter ku eshte e nevojshme sipas ligjit.

Ky Statut i Shoqerise me pergjegjesi te kufizuar The Agent Shpk, hartohet ne dy kopje ne gjuhen shqipe, qe do te kene te njejten vlore secila.

**ORTAKU I SHOQERISE**

Marlinda Zotaj

Marlinda Zotaj